

Thirrje për të marr pjesë në trajnimet e TACSOs “Si të përgatitet projekt propozimi – forma e plotë e aplikimit” në përgjigje të thirrjes për projekt propozime EIDHR 2011

3 nëntor 2011

Projekti Asistencë Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO) me qëllim të mbështetjes së OSHC-ve të Kosovës në aplikimin për thirrjen për propozime EIDHR ka mbajtur një varg sesione informuese në tërë Kosovën, duke informuar OSHC-të për thirrjen e hapur për propozime të EIDHR, objektivat, rregullat dhe kërkesat e thirrjes. Gjithashtu TACSO do të ofrojë **trajnime tre-ditore** ku detalisht do të elaborohet përgatitja e formës së plotë të aplikimit në përputhje me objektivat, rregullat dhe kërkesat e thirrjes. Gjenerimi më poshtë orarin e trajnimeve. Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë kërkon projekt propozime që kanë të bëjnë me fuqizimin e rolit të shoqërisë civile në promovimin e të drejtave të njeriut dhe reformave demokratike, parandalimit të konflikteve dhe përkrahjes së konsolidimit të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit politik në Kosovë.

Sesioni trajnues I (trajnimi do të mbahet në gjuhën shqipe)		
“Si të përgatitet projekt propozimi - forma e plotë e aplikimit”	16-19 nëntor	Hotel “Nora”- Klinë
Sesioni trajnues II (trajnimi do të mbahet në gjuhën shqipe)		
“Si të përgatitet projekt propozimi - forma e plotë e aplikimit”	23-26 nëntor	Hotel ‘Nora’- Klinë
Sesioni trajnues III (trajnimi do të mbahet në gjuhën serbe)		
“Si të përgatitet projekt propozimi - forma e plotë e aplikimit”	1-3 dhjetor 2011	Qendra Informuese dhe Kulturore e BE-së Mitrovicë

Për të përfitur nga programi trajnues i TACSOs ju lutem regjistroni organizatën tuaj përmes plotësimit të formës së bashkangjitur të regjistrimit. **Ju lutem dërgoni formën e regjistrimit deri më 9 nëntor 2011, 17:00 në info.ko@tacso.org**. Nga pjesëmarrësit e selektuar do të kërkohet të përcjellin tërë programin e trajnimit (tri ditë të plota të trajnimit). TACSO do të mbulojë të gjitha shpenzimet e trajnimit.